



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME



Npi – 01/415 datë: 16.12.2022

Bazuar në nenet 12.2 (pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes, Nr. 01-06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e XII për vitin 2022, e mbajtur më ____/____2022, propozon këtë:

DRAFT - DEKLARATË

1. Kuvendi i Komunës së Shtimes do të jetë gjithmonë pjesë e angazhimeve për përhapjen e të vërtetës, për Gjenocidin që ka ndodhur në Kosovë, gjatë luftës të vitit 1998-1999, por jo vetëm, si dhe për ndëshkimin dhe dënimin e krimeve të kryera nga shteti i Serbisë ndaj popullit shqiptar.
2. Gjenocidi do të mbetet plagë e hapur derisa autorët e tij mbeten të pandëshkuar, të padënuar dhe aq më keq pa ngritjen e aktakuzave nga cilido nivel, vendor apo ndërkombëtar. Gjenocidi është plagë e hapur edhe për faktin se ende kanë mbetur pa u gjykuar dhe dënuar krimet dhe gjenocidi i kryer ndaj popullatës civile në komunën e Shtimes e veçmas në fshatin Reçak, ku më 15 Janar 1999, forcat serbe kryen aktin Gjenocidar, gjatë të cilit u masakruan 42 civilë shqiptarë e njohur si krimi më i rëndë që njeh njerëzimi - “Masakra e Reçakut”.
3. Ne bashkohemi dhe do të japim kontributin tonë në përhapjen e të së vërtetës dhe kërkimit të drejtësisë për viktimat e Gjenocidit në Kosovë duke kërkuar përgjegjësi para drejtësisë ndërkombëtare, dënimin dhe zbardhjen e krimeve të bëra nga Serbia, sipas “Konventës, për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, 9 dhjetor 1948” si dhe “Konventa e IV e Gjenevës për mbrojtjen e Personave Civil në kohë Luftë, si dhe Protokolleve Shtesë I dhe II të vitit 1977” .
4. Kuvendi i Komunës së Shtimes e konsideron serioze thirrjen e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” prandaj i bashkohet çdo lloj aktiviteti që i kontribuon përhapjes të së vërtetës dhe kërkimit të drejtësisë për viktimat e Gjenocidit.



Kryesues i Kuvendit
Adnan Ademi